



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivered	31.05.2021	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	In Prok In Prok In Prok	Shtojca Prilog Appendix
Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK 2754/2021	115	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.330/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2811/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.609/2019, të datës 07.10.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Leletiq, Komuna e Lipjani, kundër organit të punësimit Thesari i Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe neni 18 paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.609/2019, e datës 07.10.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KZKA 2/2019 i datës 01.10.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Thesarin e Kosovës.

### A r s y e t i m

Ministria e Financave/Thesari i Kosovës, sipas autorizimit të datës 30.07.2019 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 31.07.2019 ka shpallur konkurs për plotësimin e pozitës "Zyrtar Ligjor 2" në Divizionin për Administratë dhe IT, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Kësaj procedure të rekrutimit, i është nënshtruar edhe ankuesi, mirëpo i njëjti nuk ka arritur të kalojë testin me shkrim dhe në këtë mënyrë nuk është ftuar në fazat e mëtejme të testimit.



Thesari i Kosovës, me datë 09.09.2019 ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin suksesshëm, ku sipas këtij njoftimi kandidati Ideal Kastrati është përzgjedh si kandidate i suksesshëm për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2". Kundër këtij njoftimi ankuesi me datë 17.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Thesarin e Kosovës. Ky i fundit përmes Vendimit me numër KZKA 2/2019 të datës 01.10.2019, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Kundër Vendimit me numër KZKA 2/2019 të datës 01.10.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 11.10.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Thesari i Kosovës. Këshilli me datë 16.10.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë nga organi i punësimit se bashku me provat e çështjes në procedurë ankimore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 16.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin Anr.2811/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 07.10.2019 të parashtruar nga ankuesi

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Aktgjykimin A.nr.2811/2019 të datës 16.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Ankesën me me numër protokolli 4678/2019 e datës 07.10.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 17.09.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Thesarit të Kosovës; Vendim me numër Vendimi me numër KZKA 2/2019 i datës 01.10.2019; Diplomën me numër 2648 të datës 11.07.2014; Certifikatën e datës 01.12.2015; Vërtetimin e datës 27.12.2018; Vërtetimin e datës 04.08.2019; Certifikatën e datës 27.06.2018; Certifikatën e datës 22.09.2007; Përgjigjen në ankesë të datës 16.10.2019; Kërkesën e datës 11.10.2019 nga KPMSHCK-së; Autorizimin e datës 30.07.2019 të Departamentit për Shërbimin Civil; Konkursin e datës 31.07.2019; Vendimin me numër 30/2019 të datës 20.08.2019; Testin për punësim i aplikuesit Testin për punësim i Ideal Kastratit; Listën e kandidatëve që e kanë kaluar testin me shkrim; Listën e kandidatëve që janë kualifikuar për test; E-mailin e datës 26.08.2019, njoftimin për testimin me shkrim; Njoftimin e datës 09.09.2019; Kërkesën për punësim Form.MAP-SHCK-03 i datës 14.08.2019 Pasqyrën e datës 14.08.2019 e Trustit për Marrëveshjen për shërbime të veçanta e datës 01.03.2019 e Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.06.2019 e Kërkesën për punësim Form.MAP-SHCK-03 e datës 13.08.2019 Kontratën e datës 01.10.2017 deri me date 01.11.2018 nga Kompania e Shërbimeve Ligjore në Kosovë; Kontratën për Shërbime e datës 01.05.2016 deri me date 01.11.2016 nga Kompania e Shërbimeve Ligjore në Kosovë; Certifikatën e gjuhës angleze e datës 08.12.2014; Certifikatën e Universitetit të Prishtinës të datës 16.06.2017; Letër rekomandimin e datës 12.08.2016; Pasqyra e Trustit të Kosovës lëshuar me datë 25.06.2019; Prova shtesë sipas kërkesës së Zyrtares së lartë për bashkepunim profesional për plotësim të lëndës, me përgjigje të datës



31.05.2021:Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues Form.MAP-SHCK-11; Form.MAP-SHCK-09 nga Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale nga Komisioni Rekrutues; Aktet e Emërimit të Komisionit Përzgjedhës; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listë të ngushtë Form.MAP-SHCK-05 dhe Form.MAP-SHC-07a; Vlerësimin Individual i Kandidateve për Vendin e Punës për të Cilin nuk Kërkohej Njohje e Ndonjë Gjuhe të Huaj Form.MAP-SHCK-08a; Renditjen përfundimtare të kandidateve Form.MAP-SHCK-10; Kërkesën për fillimin e rekrutimit (punësimit) Form.MAP-SHCK-01; Rekomandimin e datës 09.09.2019 për kandidatin e rekomanduar nga Menaxheri i personelit në Thesarin e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Në ankesën e parashtruar ankuesi pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar Ligjor 2", në Divizionin për Administratë dhe IT, janë bërë shkelje të dispozitave materiale, duke shtuar se testi me shkrim nuk ka qenë në pajtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe se anëtarët e Komisionit Përzgjedhës kanë qenë jo profesional gjegjësisht ekonomistë dhe të njëjtit nuk kanë pas njohuri ligjore për vlerësimin e testit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke ju referuar konkursit me numër referencës 21/2019/TH-LI/60 të datës 31.07.2019, ka konstatuar se kriteret themelore për pozitën e punës „Zyrtar Ligjor 2“, kanë qenë: *Diplome Universitare në fushën e Fakultetit juridike, Përvojë profesionale -2 vjeçare pas diplomimit.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Komisioni Përzgjedhës, ka qenë në përbërje nga ekonomistë të cilët sipas deklaratimit të ankuesit nuk kanë njohuri profesionale ligjore, Kolegji pas vlerësimit të provave të lëndës ka konstatuar se përbërja e Komisionit Përzgjedhës sipas Vendimit me numër Nr.30/2019 të datës 20.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, ka qenë në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili ka përcaktuar se: *Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHC përbëhet nga anëtarë të cilët kanë pozita më të lartë se pozita që duhet të rekrutohet, po një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor, përkatësisht është respektuar hierarkia e pozitës si dhe parimi i përfaqësimit gjinor, e mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.*

Pretendimi ankimor së testi me shkrim nuk ka qenë në pajtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nuk qëndron sepse me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 36 përcaktohet se: *1.Testi me shkrim për kandidatet përmban 30 deri 50 pyetje, ndërsa përbehet prej këtyre pjesëve; 1.1 Pjesa e njohurive të përgjithshme. Në këtë pjesë kandidateve u parashatrohen 3 deri 5 pyetje në formë eseje; 1.2 Pjesa e aftësive të përgjithshme. Në këtë pjesë kandidateve u parashatrohen 10 deri 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta; 1.3 Pjesa e njohurive që lidhet me vendin e punës. Në këtë pjesë kandidateve u parashatrohen 15 deri 23 pyetje, të cilat janë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% në formë eseje; 1.4 Pjesa e njohurive për gjuhë të huaja. Kjo pjesë zhvillohet për kandidatet të cilët konkurrojnë për pozita ku kërkohej njohuri e gjuhëve të huaja. Në këtë pjesë kandidateve u parashatrohen prej 5 deri 7 pyetje me përgjigje të shumëfishta*



dhe dy ese për të testuar fjalorin, gramatikën, sintaksën dhe kuptimin e teksteve të shkruara në një gjuhë të huaj. Andaj, në kuptim të kësaj rregullore, Kolegji vlerëson se testi me shkrim në Pjesën e Njohurive të Përgjithshme ka përmbajtur 5 pyetje në formë të eses, Pjesa e dytë e Aftësive të Përgjithshme dhe Personalitetit, ka përmbajtur 15 pyetje me zgjidhje të shumëfishta, ndërsa Pjesa e Tretë Njohuritë që lidhen me Vendin e Punës ka përmbajtur 20 pyetja nga të cilat 10 me zgjidhje të shumëfishta dhe dhjetë në formë eseje. Kështu që në këtë rast, Kolegji vlerëson se testi ka qenë në pajtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil, ka vlerësuar si kandidatin me të suksesshëm ne gjithsej 62.20 pikë, andaj Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës me rastin e rekomandimit të kandidatit me të suksesshëm për emërim në Shërbimin Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur ka plotësuar kriteret e konkursit lidhur me kualifikimin dhe përvojën e punës, sepse sipas shkresave të lëndës është konstatuar se i njëjti me datë 16.09.2015 ka përfunduar studimet themelor dhe ka marrë titullin- Jurist i Diplomuar-Bachelor në Universitetin e Prishtinës, ndërsa përkitazi me përvojën e punës posedon kontratat e punës/Shërbimit si dhe pasqyrën e trustit nga të cilat vërtetohet se kandidati i zgjedhur ka punuar në pozitën e Zyrtarit Ligjor në Kompaninë Kosovare për Shërbime Ligjore, dhe atë nga data 06.05.2016 deri me datë 01.11.2016, nga data 01.10.2017 deri me datë 01.11.2018, nga data 01.12.2018 deri me datë 13.09.2019, pra mbi 2 vite përvojë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe pas shtjellimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e procedurës rekrutuese, konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë, Kolegji ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Thesarit të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër KZKA 2/2019 të datës 01.10.2019, ka arritur që të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.330/2021**

 **Zyle Millaku GOJNOVCI**

**Procesmbajtëse**

 **Jeton KOÇA**

**Kryetar i Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Thesarin e Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Thesarin e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.